

R E P U B L I K A E K O S O V È S

/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICË /MUNICIPAL COURT OF MITROVICA

C.B 756/2013

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Gjyqtari Ragip Kadriu ne
qeshjen juridike te paditesit; nga Mitrovica te cilin e perfaqson
Avokat nga Prishtina sipas autorizimit , kunder te paditur;
ne Prishtine te eilen e perfaqson; sipas autorizimit me
shkrim, baza e kontestit; kompenzim demi, vlera e lendes se kontestit; 11.340,00 Euro,
pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt. 22.05.2014 jep kete;

A K T G J Y K I M

I-PJESERISHTE aprovohet kerkespadi a ne
Mitrovica dhe DETYROHET e paditura " ne
Prishtine qe paditesit ti kompenzoje demin material dhe jomaterial te shkaktuar nga
perdorimi i mjetit motorik, vetur e Markes " me targa ne cilsin
e pasagjerit te cilin e drejtonte ne aksidentin e trafikut te dt. 09.07.2013
dhe ate;

-ne emer te dhimbjeve trupore fizike , shumen prej.....	3.500,00 Euro
-ne emer te friges se perjetuar, shumen prej.....	2.500,00 Euro.
-ne emer te shemtimit , shumen prej.....	1.000,00 Euro
-ne emer te ndihmes dhe kujdesit te personit te trete, shumen	140,00 Euro.
-ne emer te ushqimit te perforuar ,shumen prej.....	220,00 Euro.
-ne emer te rehabilitimit fizotropik-klimatik, shumen prej.....	280,00 Euro

Te gjitha keto me kamat 8 % ne vit, duke filluar nga dt gjykimit dt. 22.05.2014 e
gjere ne pagesen definitive ne afat preje 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

II- Kerkespadi prtej pjeses se gjikuar REFUZOHET SI E PABAZUAR dhe

-ne emer te dhimbjeve trupore fizike, shumen prej.....	1.700,00 Euro
-ne emer te friges se perjetuar, shumen perej	1.000,00, Euro
-ne emer te shemtimit, shumen prej	1,000,00 Euro

~~III- Obiigohet e paditura e paditave seje te i kompenzoi shpenzimit e procedurave kontestimore ne shume prej 670.00 Euro, ne afalin preje 15 diteve nga ditat e pranimit te ketije aktgjykimi.~~

Arsyjetim

Paditesi ne padine e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tije ka theksuar se; me dt. 09.07.2013 ne Rrugen Mitrovice-Prishtine ka ndodhur aksident trafiku ne te cilin aksident ka pesuar lendime te renda trupore paditesi.

Gjere te aksidenti ka ardhur ku paditesi ishte ne cili te pasagjerit duke udhtuar me automjetin e tipit ~~me targa~~ te cilin e drejtonte i cili nuk pershtat shpejtsin e levizjes kushteve te rruges, humb drejtimin e automjetit dhe perfundon jasht rruge duke u rrokullisur disa her me qast shkakton aksident trafiku me deme materiale dhe lendime trupore.

I autorizuari i paditesit pase konstatimit dhe mendimit te Eksperteve te mjeksic, beri precizimin e kerkespadise ashtu qe kerkoi;

- ne emer te dhimbjeve trupore fizike kerkoi shumen prej nga 5.200,00 Euro,
- ne emer te friges se perjetuar shumen prej nga 3.500,00 Euro
- ne emer te shemtimit sumen prej 2.000,00 Euro
- ne emer te rehabilitimit klimatik shumen prej nga 280,00 Euro
- ne emer te ndihmes dhe kujdesit te personit te tret, shumen nga..... 140,00 Euro.
- ne emer te ushqimit te perforeuar, shumen prej nga 220,00 Euro

Te gjitha me kamat iigjore nga paraqija e padise e deri ne pagesen definitive.

Ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoje ne tersi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore i kerkoi.

I autorizuari i te paditures ne pergjigje te padise si dhe precizimit te kerkespadise e konteston ne tersi kerkespadin e paditesit si bazen ashtu edhe lartesine duke theksuar se ; gjer me tanj nuk eshte vertetuar baza juridike dhe pergjegjesia e te paditures si dhe lartisia e kerkespadise eshte shume e larte ne baze te lendimeve te psuara .

Ne fjalen perfundimtarci propozon gjykates qe te merr aktgjykim te drejt ne baze te kriterieve te caktuara per lendime te lehta trupore.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor zhvilloi provat e nevojshme dhe pase administrimit dhe vleresimit te njejtave ne kuptim te nen.8 te LPK erdhj ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitive te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne veprime e shqyrimit kryesor lexoi; Raportin e aksidentit nga Policia e Kosovës nr. 09.07.2013, ndegjoi Ekspertet e mjeksi Dr. [redacted] prane QKUK-se ne Prishtine si dhe Dr. [redacted] - se ne Prishtine dhe konstatoi kete gjendje lëtikë, [redacted]

Ne baze te Raportit te aksidentit te perpiluar nga Policia e Kosovës te cekur me larte vertetoret se me dt. 09.07.2013 ne Rr. [redacted] ne Fsh. [redacted] ka ndodhur aksident trafiku me qast paditesi ka psuar lendime trupore i cili ka qene ne cili te pasagjerit ne automjetin e sipercekur te cilin e ka dreitur. [redacted] dhe se ky automjet ka qene i sigruar me nr. te polises [redacted] me dt. te skadimit 26.12.2013.

Ne baze te konstatimit dhe mendimit te ekspertve te mjeksise te sipercekur, vertetohet se paditesi ne kete aksident trafiku ka psuar, [lendim te lehte trupor], dhe se i njejti ka perjetuar dhimbje fizike te intenzitetit te rende 72-ore, dhimbje fizike te intenzitetit te mesem, 3-jav dhe dhimbje te intenzitetit te ulet ne kohzgjatje 8-muaj.

I njejti ka perjetuar Frige sekundare te intenzitetit te larte, afer 24 ore, .Friga e intenzitetit te mesem ka zgjatur 4-jave dhe frig te intenzitetit te ulet rrith 2-jave.

I njejti ka shembim shum te lehte ne regionin e nyjes se dores se djathite qe i per gjigjet vendit te lendimit ne ndeshjen e komunikacionit te dt. 09.07 2013.

Ushqimi i perfosuar ka qene i nevojshem per 2-jave dhe se ka nevoje per Terapi fizikale dhe rehabilitim ne kohzgjatje prej 2-jave.

Mbeshtetur ne tersine e provave te administruara e debatuara ne gjykim, perfshire akt eksperimentin mjeko-ligjor, gjykata kerkespadine e paditesit pjeserisht e aprovoi si ne dispozitiv te ketije aktgjykiti, konform nen. 177.2, nen 183.1.2, nen 918 dhe 940 te Ligjt per marrdhenjet e detyrimore ,[Ligi nr 04/L-077].

Me dispoziten e nen 177.2 te LMD eshte parapar, qe personi perjegjes ka per detyre qe personit qe i ka shkaktuar lendim trupor apo demtim te shendetit, ai ka per detyr ti shperblej shpenzimet e mjekimit te tije nga lendimet e marra dhe shpenzimet tjera te nevojshme par mjekim.

Nepermjet demshperblimit synohet pikerisht rivendosja e plot e te demtuarit [restitutio in integrum] ne gjendjen e meparshme [status quo ante], ne te cilen ai do te gjendej nese nuk ndodhje fakti i paligjshem.

Gjykata gjate vendosjes lidhur me kartesin e kompenzimit te demit jomaterial, pati parasysh te gjitha trethanat e parapara me nen.183 al.1 dhe 2 te LMD dhe ate; sa i perket dhimbjeve fizike gjykata pati parasysh, kohzgjatjen dhe intenzitetin e dhimbjeve te perjetuara fizike, llojin e lendimit te cilin paditesi e ka perjetuar, pastaje kohezgjatjen e sherimit, ndertijet operative, imobilizimi si dhe dhimbjet gjate rehabilitimit dhe erdhia ne perfundim se me shumat e caktuara eshte nje satisfacion real per paditesin.dhe permbushe ndjenjen e se drejtës.

Sa i perket dhimbjeve fizike te paerjetuara , gjykata pati parasysh rrethanat se neq eksperzi za mjeksore u vertetua se paditesi ka perje ue dhimbje fizike te intensitetit prej 72 ore, te mesme 3 javje dhe te uljet 8-ja veprandaj vendosi shumen si ne dispozitive, kete forme te demit jomaterial.

Sa i perket friges se perjetuar te paditesit gjykata pati parasysh faktin se nga eksperzia mjeksore u vertetua se paditesi ka perjetuar rrege e intensitetit te lartë 24 ore te mesme 4-jave dhe te uljet 2-jave, prandaj gjykata vendosi shumen si ne dispozitiv per kete forme te demit jomaterial.

Sa i perket shemtimit qe ka puar paditesi, nga konstatimi i ekspertve u konstatua se paditesi ka shemtim te shkalles shum te lehte , prandaj vendosi si ne dispozitiv per kete form te demit jomaterial e duke pasur parasysh moshen e re te paditesi, se shemtimi eshte ne doren e djathje i dukshem dhe ne vendin ku nuk munde te mbulohet me rroba.

Sa i perkete ndihmes se huaje nga konstatimi i eksperteve u konstatua se paditesi ka pasur nevoje per kujdesin e huaje per 14 dite, andaj vendosi si ne dispozitiv per kete forme te demit material.

Sa i perket ushqimit te perfocuar nga konstatimi i ekspertve u konstatua se i njejt ka pasur nevoj ne kohzgjatje 2-jave. Prandaj vendosi si ne dispozitiv per kete form te demit material.

Nga ekspertiza- mjeksore, gjithashtu u vertetua se paditesi per shkak te ketyre lendimeve ka nevoje per terapi fizikale dhe rehabilitim ne kohzgjatje prej 14-diteve , prandaj u vendos si ne dispozitiv per kete forme te demit material., pasi qe keto shpenzime nuk jane te mbuluara gjer me tani me ndonje forme te mbrojtjes shendetsore.

Gjykata kerkespadine pertej pjeses se gjykuar si nen pikën II te dispozitivit e refuzoi si te pabazuar, duke konsideruar se me shumat e caktuara paraqesin kompenzimin real ndaje paditesit duke pasur parasysh kriteret dhe masat per llogaritjen e lartesive te demeve jo materiale dhe materiale te Kompanit e sigurimeve, praktikes gjyqesore,dhe duke u mbeshtetur ne ekspertizen mjeksore, gjykata konsideron se ne rastin konkret paditesit i vene satsifikacion real nga fatkeqesia dhe permbush ndjenjen e se drejtës e duke pasur parasysh te gjitha rrethanat te cilat ndikojn ne lartesin e kompenzimit te demit per keto forma te demit material dhe jomaterial.

Gjykata vlersoi pretendimine te autorizuarut te paditures dhe si te tille e konsideron si te pabazuar, te paargumenuar dhe te drejtuar me qellim te shmangejes nga obligimi i kompenzimit te ketije demi sa i perkete pjeses aprovuese si nen pikën I- te dispozitivit te aktgjykit, nga se me provat e zhvilluara me pamedyshje u argumentua fakti se gjere te aksidenti ne fjale ka ardhur si pasoje e leshimeve te vozitesit i cili ka drejtuar automjetin i cili ka qene i siguruar per perqjeqesin ndaj personave te tret te e paditura, sipas polses se sigurimit te lartecur per sigurimin e detyrushem te mbajtesve te injeteve motorike dhe se paditesi nga kjo fatkeqesi ka pesuar lendimet trupre si u cek me larte ne konstatimin dhe mendimin e ekspertve- mjeksore. Prandaj eshte irrelevant pretendimi i te paditures se nuk eshte vertetuar perqjeqesia e te paditures nga se paditesi ketu ka qene ne cili te pasqierit dmth; person i treti ne automjetin me te cilin eshte shkaktuar aksidenti, prandaj ne rrethana te ketilla e konform nen . 159.4 te te njejtligj

5

eshte percaktuar se... per denimin e pune personal e tret zotruesit e mjeteve motorike
pergjigjen solidarisht.

Nga provat e administruara ne dosjen gjyqesore, rezulton e vertetuar se eshte konsumuar fakti i paligjshem ne te tre elementet objektive e subjektive te tij; ngjarja e demit nga sjellja e paligjshmëri non iuse, dhe me faj[culpa] te te tretit, -vozitesit, Ferdi Klisurica si dhe shkaktimi i lendimit te paditesit. Prandaj gjykata nuk qmon te thrrase ekspert per konstatimin dhe sqarimin e ktyre rr Ethanave te faktit. Ne vijim gjykata ka qmuar te caktoi ekspertizen -mjeksole per te dhene mendimin e specializuar ne funksion te percaktimit dhe llogaritjes se vlers se demit material e jomaterial te kerkuar me ane te padise.

Gjykata konstatimindhe mendimin e ekspertve mjeksor i aprovoi ne tersi si te bazuara dhe objektive ne mase te mjaftuara te argumentuara dhe te dhena ne harmoni me rregulat e shkences dhe profesionit te tyre dhe se konstatimet e tyre nuk u prapsuan nga palet ndegjyqese.

Vendimi mbi kamuten bazohet ne dispoziten e nen. 378 te LMD, duke i u nisur sipas normes konforme -vjetore prej 8 % e cila norme ne vendin e permbushjes, paguhet ne deponimet kursimore pa caktim detinimi mbi 1 vit, duke filluar nga dt., e gjykimit e gjere ne pagesen definitive.

Vbendimi mbi shpenzimet kontestimore bazohet ne dispoziten e nen. 452.3 te LPK, duke iu njojur paditeseve shpenzimet dhe ate; per perpilimin e padise 93,60 Euro , per pjesmarrje nga ana e te autorizuarit te tije ne 3- seanca, shumen prej nga. 121,68 Euro, konform nr. Tarifor 6 e 7 te TA dhe nen. 453.2. te LPK, si dhe ne emer te ekspertizes mjeksore, shumen prej 200.00 Euro, si dhe ne emer te taksave per padi dhe aktgjykim, shumen prej. 112,00 Euro, sipas nen. 10.1 dhe 10.12 te Tarifes se Taksave gjyqsore.

Nga te cekurat u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendi.

GJYKATA THEMELORE NE VUSHTRRI
C. nr.756/2013 dt.22.05.2014.

G j y q t a n i,
Ragip Kadriu,

UDHEZIME JURIDIK: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi, Gjykates se Apelit te Kosoves e nepermjet te kesaje gjykate.